


Manuali referencë për përdoruesin

Seria Split R32 – Depozita e ujit të ngrohtë sanitar



Download the
ONECTA app

STAND BY ME

Discover our service offer

EKHWET90B ▲ V3 ▼
EKHWET(U)120B ▲ V3 ▼

▲ = 1, 2, 3, ..., 9, A, B, C, ..., Z
▼ = , 1, 2, 3, ..., 9

Tabela e përmbajtjes

1 Rreth këtij dokumenti	4
1.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve.....	5
2 Udhëzimet e sigurisë për përdoruesin	7
2.1 Të përgjithshme.....	7
2.2 Udhëzimet për përdorim të sigurt.....	8
3 Rreth sistemit	10
3.1 Komponentët në një ndërtim tipik të sistemit	10
4 Udhëzuesi i shpejtë	11
4.1 Niveli i autorizimit të përdoruesit	11
4.2 Uji i ngrohtë sanitar	12
5 Operimi	13
5.1 Ndërfaqja e përdoruesit: Përmbledhje.....	13
5.2 Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për përdoruesin	15
5.3 Pamjet e mundshme të ekranit: Përmbledhje.....	16
5.3.1 Ekran kryesor	16
5.3.2 Pamja e menysë kryesore.....	17
5.3.3 Pamja e ekranit të vlerës së caktuar.....	18
5.3.4 Pamja e detajuar e ekranit me vlerat	19
5.4 Ndezja dhe fikja e funksionimit.....	20
5.4.1 Tregimi vizual	20
5.4.2 Për ta ndezur ose për ta fikur	20
5.5 Leximi i informacionit.....	20
5.6 Kontrolli i ujit të ngrohtë sanitar	21
5.6.1 Rreth kontrollit të ujit të ngrohtë sanitar.....	21
5.6.2 Modaliteti i ringrohjes	22
5.6.3 Modaliteti i programuar	22
5.6.4 Modaliteti i programuar + ringrohje	23
5.6.5 Për të ndryshuar temperaturën e ujit të ngrohtë sanitar.....	24
5.6.6 Përdorimi i funksionimit të fuqishëm të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar.....	24
5.7 Vlerat e paracaktuara dhe programet	25
5.7.1 Përdorimi i vlerave të paracaktuara	25
5.7.2 Përdorimi dhe programimi i programeve	26
5.7.3 Ekran i programit: Shembull ilustrues	28
5.8 Kurba në varësi të motit.....	32
5.8.1 Çfarë është kurba në varësi të motit?	32
5.8.2 Kurba me 2 pika	32
5.8.3 Kurba pjerrësi-kompensim	33
5.8.4 Përdorimi i kurbave në varësi të motit.....	34
5.9 Programi i prioritetit.....	36
5.10 Modaliteti i funksionimit	37
5.11 Funksionet e tjera.....	38
5.11.1 Për të konfiguruar orën dhe datën.....	38
5.11.2 Përdorimi i modalitetit të qetë.....	38
5.11.3 Përdorimi i modalitetit të pushimeve	39
5.11.4 Përdorimi i Wi-Fi	40
6 Këshilla për kursimin e energjisë	42
7 Mirëmbajtja dhe shërbimi	43
7.1 Përmbledhje: Mirëmbajtja dhe shërbimi.....	43
8 Zgjidhja e problemeve	45
8.1 Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti	45
8.2 Për të kontrolluar historinë e defekteve.....	45
8.3 Simptoma: Uji në çezmë është shumë i ftohtë	46
8.4 Simptoma: Prishja e pompës së nxehtësisë.....	46
9 Ndryshimi i vendndodhjes	48
9.1 Përmbledhje: Ndryshimi i vendndodhjes.....	48
10 Hedhja	49
11 Fjalor	50

12 Cilësimet për instaluesin: Tabelat për plotësim nga instaluesi	51
12.1 Ndihmuesi i konfigurimit.....	51
12.2 Menyja e cilësimeve	51

1 Rreth këtij dokumenti

Faleminderit që bletë produktin. Ju lutemi:

- Lexoni me kujdes dokumentacionin para përdorimit të ndërfaqes së përdoruesit për të garantuar performancën më të mirë të mundshme.
- Kërkojini instaluesit t'ju informojë për cilësimet që ka përdorur për të konfiguruar sistemin tuaj. Kontrolloni nëse i ka plotësuar tabelat e cilësimeve të instaluesit. Nëse JO, kërkojani përdoruesit ta bëjë.
- Ruajeni dokumentacionin për referencë në të ardhmen.

Audienca e synuar

Përdoruesit fundorë

Seti i dokumentacionit

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

- **Masa sigurie të përgjithshme:**
 - Instruksionet e sigurisë që duhet të lexoni përpara instalimit
 - Format: printuar në letër (në kutinë e njësisë së brendshme)
- **Manuali i përdorimit:**
 - Udhëzues i shpejtë për përdorimin bazë
 - Format: printuar në letër (në kutinë e njësisë së brendshme)
- **Manuali referencë për përdoruesin:**
 - Instruksione të detajuara hap pas hapi dhe informacione mbështetëse për përdorimin bazë dhe të avancuar
 - Format: Skedarët digjitalë në <https://www.daikin.eu>. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.
- **Manuali i montimit – Njësia e jashtme:**
 - Instruksionet e montimit
 - Format: printuar në letër (në kutinë e njësisë së jashtme)
- **Manuali i montimit – Njësia e brendshme:**
 - Instruksionet e montimit
 - Format: printuar në letër (në kutinë e njësisë së brendshme)
- **Manuali referencë për instaluesin:**
 - Përgatitja për montimin, praktikat e mira, të dhënat referencë, ...
 - Format: Skedarët digjitalë në <https://www.daikin.eu>. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.

Rishikimet më të fundit të dokumentacionit të siguar mund të disponohen në faqen rajonale Daikin ose përmes instaluesit tuaj.

Udhëzimet origjinale janë të shkruara në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

Aplikacioni ONECTA



Nëse konfigurohet nga instaluesi juaj, ju mund të përdorni aplikacionin ONECTA për të kontrolluar dhe për të monitoruar statusin e sistemit. Për më shumë informacion, shihni:

<http://www.onlinecontroller.daikineurope.com/>



Pemët e lundrimit

Pemët e lundrimit (për shembull: **[5.1]**) ju ndihmojnë të lokalizoni se ku ndodheni në strukturën e menysë së ndërfaqes së përdoruesit.

1	Për të aktivizuar pemët e lundrimit: Në ekranin kryesor ose në ekranin e menysë kryesore, shtypni butonin e ndihmës. Pemët e lundrimit shfaqen në cepin majtas lart të ekranit.	?
2	Për të çaktivizuar pemët e lundrimit: Shtypni përsëri butonin e ndihmës.	?

Ky dokument përmend edhe këto pemë lundrimi. **Shembull:**

1	Shkoni te [5.1]: Depozita > Funkcioni i fuqishëm.	
---	---	--

Kjo do të thotë:

1	Duke u nisur nga ekranin kryesor, rrotulloni çelësin rrotullues të majtë dhe shkoni te Depozita . 	
2	Shtypni çelësin rrotullues të majtë për të hyrë te nënmenyja.	
3	Rrotulloni çelësin rrotullues të majtë dhe shkoni te Funksioni i fuqishëm . 	
4	Shtypni çelësin rrotullues të majtë për të hyrë te nënmenyja.	

1.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve

**RREZIK**

Tregon një situatë që rezulton në vdekje ose dëmtim të rëndë.

**RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE**

Tregon një situatë që mund të rezultojë në goditje elektrike.

**RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI**

Tregon një situatë që mund të rezultojë në djegie/përvëlim për shkak të temperaturave ekstreme të ngrohta ose të ftohta.

**RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI**

Tregon një situatë, që mund të rezultojë në shpërthim.

**PARALAJMËRIM**

Tregon një situatë që mund të rezultojë në vdekje ose dëmtim të rëndë.

**ALARM: MATERIAL I NDEZSHËM****KUJDES**

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtim të lehtë ose të mesëm.

**NJOFTIM**

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtimin e pajisjeve ose të pronës.

**INFORMACION**

Tregon këshilla të dobishme ose informacion shtesë.

Simbolet e përdorura në njësi:

Simboli	Shpjegimi
	Para instalimit, lexoni manualin e instalimit dhe përdorimit dhe fletën e udhëzimit për lidhjet elektrike.
	Para kryerjes së detyrave të mirëmbajtjes dhe shërbimit, lexoni manualin e shërbimit.
	Për më shumë informacion, shikoni instaluesin dhe udhëzuesin referencë të përdoruesit.
	Njësia përmban pjesë rrotulluese. Bëni kujdes kur i bëni njësisë servis ose inspektim.

Simbolet e përdorura në dokumentacion:

Simboli	Shpjegimi
	Tregon një titull figure ose një referencë për të. Shembull: "▲ 1–3 Titulli i figurës" do të thotë "Figura 3 në kapitullin 1".
	Tregon një titull tabele ose një referencë për të. Shembull: "■ 1–3 Titulli i tabelës" do të thotë "Tabela 3 në kapitullin 1".

2 Udhëzimet e sigurisë për përdoruesin

Zbatoni gjithmonë udhëzimet për sigurinë dhe rregullat vijuese.

2.1 Të përgjithshme



PARALAJMËRIM

Nëse NUK jeni të sigurt sesi ta përdorni njësine, kontaktoni me instaluesin.



PARALAJMËRIM

Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe personat me aftësi të reduktuara fizike, ndijore ose mendore ose me mungesë përvojë dhe njohurie, nëse u janë dhënë mbikëqyrje ose udhëzime lidhur me përdorimin e pajisjes në një mënyrë të sigurt dhe për të kuptuar përfshirjen e rreziqeve.

Fëmijët NUK do të luajnë me pajisjen.

Pastrimi dhe mirëmbajtja e përdoruesit NUK do të kryhet nga fëmijë pa mbikëqyrje.



PARALAJMËRIM

Për të parandaluar goditjet elektrike ose zjarrin:

- MOS e shpëlaj njësine.
- MOS e përdor njësine me duar të lagura.
- MOS vendos asnjë send që përmban ujë mbi njësi.



KUJDES

- MOS vendosni sende ose pajisje mbi njësine.
- MOS u ulni, mos hipni ose mos qëndroni mbi njësine.

- Njësitë janë të shënuara me këtë simbol:



Kjo do të thotë se produktet elektrike dhe elektronike NUK mund të përzierhen me mbeturinat e paklasifikuara shtëpiake. MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET bërë nga një instalues i autorizuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim. Duke garantuar që ky produkt do të hidhet si duhet, ju do të ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Për më shumë informacion, kontaktoni instaluesin tuaj ose autoritetin lokal.

- Bateritë janë të shënuara me këtë simbol:



Kjo do të thotë se bateritë NUK mund të përzierhen me mbeturinat e paklasifikuara shtëpiake. Nëse një simbol kimik është i shtypur poshtë simbolit, ky simbol kimik do të thotë se bateria mban një metal të rëndë mbi një koncentrim të caktuar.

Simbolet e mundshme kimike janë: Pb: plumb (>0,004%).

Bateritë për hedhje DUHEN trajtuar në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim. Duke garantuar që bateritë për hedhje do të hidhen si duhet, ju do të ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin njerëzor.

2.2 Udhëzimet për përdorim të sigurt



ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.



PARALAJMËRIM

Pajisja duhet të ruhet për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa burime ndezjeje që janë vazhdimisht në gjendje pune (p.sh. flakë të hapura, pajisje gazi në gjendje pune ose një ngrohës elektrik po në gjendje pune).



PARALAJMËRIM

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.

**PARALAJMËRIM**


- Ftohësi brenda njësisë është pak i djegshëm, por normalisht NUK shkakton rrjedhje. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr ose formimin e një gazi të dëmshëm.
- FIKNI çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.
- MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.

3 Rreth sistemit

Në varësi të ndërtimit të sistemit, sistemi mund të:

- Prodhojë ujë të ngrohtë sanitar

3.1 Komponentët në një ndërtim tipik të sistemit




4 Udhëzuesi i shpejtë

4.1 Niveli i autorizimit të përdoruesit

Sasia e informacionit që mund të lexoni dhe modifikoni në strukturën e menysë varet nga niveli juaj i autorizimit të përdoruesit:

- **Përdoruesi:** Modaliteti standard
- **Përdoruesi i avancuar:** Mund të lexoni dhe të modifikoni më shumë informacione

Ndryshimi i nivelit të autorizimit të përdoruesit

1	Shkoni te [B]: Profili i përdoruesit.	
		
2	Futni kodin PIN të kërkuar për nivelin e autorizimit të përdoruesit.	—
	▪ Lundroni nëpër listën e numrave dhe ndryshoni numrin e zgjedhur.	
	▪ Lëvizni kursorin nga e majta në të djathtë.	
	▪ Konfirmoni kodin PIN dhe vazhdoni më tej.	

Kodi PIN i përdoruesit

Kodi PIN për **Përdoruesi** është **0000**.



Kodi PIN për përdoruesin e avancuar

Kodi PIN për **Përdoruesi i avancuar** është **1234**. Pas futjes së kodit disponohen pika shtesë të menysë për përdoruesin.



4.2 Uji i ngrohtë sanitar

Për të ndezur ose për të fikur funksionin e ngrohjes së depozitës

	NJOFTIM	Modaliteti i dezinfektimit. Edhe nëse e fikni funksionin e ngrohjes së depozitës ([C.3]: Funksionimi > Depozita), modaliteti i dezinfektimit do të mbetet aktiv. Megjithatë, nëse e fikni atë kur dezinfektimi është në proces, ndodh një gabim AH.
1	Shkoni te [C.3]: Funksionimi > Depozita .	
2	Vendoseni funksionimin në Ndezur ose Fikur .	

Për të ndryshuar vlerën e caktuar të temperaturës së depozitës

Në modalitetin **Vetëm ringrohje**, mund të përdorni ekranin e vlerës së caktuar të depozitës për të lexuar dhe për të rregulluar temperaturën e ujit të ngrohtë sanitar.

1	Shkoni te [5]: Depozita .	
2	Rregulloni temperaturën e ujit të ngrohtë sanitar.	
	a Temperatura aktuale e ujit të ngrohtë sanitar	
	b Temperatura e dëshiruar e ujit të ngrohtë sanitar	

Në modalitetet e tjera ju vetëm mund ta shihni ekranin e vlerës së caktuar, por nuk mund ta modifikoni atë. Në vend të saj, mund të modifikoni cilësimet për **Vlera e caktuar e komfortit** [5.2], **Vlera e caktuar ekonomike** [5.3] dhe **Vlera e caktuar e ringrohjes** [5.4].

Më shumë informacion


Për më shumë informacion, shihni edhe:

- "5.4 Ndezja dhe fikja e funksionimit" [▶ 20]
- "5.6 Kontrolli i ujit të ngrohtë sanitar" [▶ 21]
- "5.7 Vlerat e paracaktuara dhe programet" [▶ 25]

5 Operimi

5.1 Ndërfaqja e përdoruesit: Përmbledhje

Ndërfaqja e përdoruesit përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:




Ekрани LCD

Ekрани LCD ka një funksion fjetjeje. Pas 15 minutash mungese veprimi në ndërfaqen e përdoruesit, ekrani errësohet. Shtypja e një butoni ose rrotullimi i një çelësi rrotullues e zgjon ekranin.

Çelësat rrotullues dhe butonat

Çelësat rrotullues dhe butonat i përdorni që:


- Të lundroni nëpër pamjet e ekranit, menytë dhe cilësimet e ekranit LCD
- Të vendosni vlerat



Artikulli	Përshkrimi
a Çelësi rrotullues i majtë	Ekрани LCD tregon një hark në anën e majtë të ekranit kur përdorni çelësin rrotullues të majtë. ▪ : Rrotulloni, pastaj shtypni çelësin rrotullues të majtë. Lundroni nëpër strukturën e menysë. ▪ : Rrotulloni çelësin rrotullues të majtë. Zgjidhni një pikë të menysë. ▪ : Shtypni çelësin rrotullues të majtë. Konfirmoni zgjedhjen ose shkoni te një nënmeny.
b Butoni i kthimit pas	: Shtypeni për t'u kthyer 1 hap pas në strukturën e menysë.
c Butoni Home	: Shtypeni për t'u kthyer në ekranin kryesor.
d Butoni i ndihmës	: Shtypeni për të shfaqur ndonjë tekst lidhur me faqen aktuale (nëse ka).

Artikulli	Përshkrimi
e Çelësi rrotullues i djathtë	Ekrani LCD tregon një hark në anën e djathtë të ekranit kur përdorni çelësin rrotullues të djathtë. ○⋯⋯🖱️: Rrotulloni, pastaj shtypni çelësin rrotullues të djathtë. Ndryshoni një vlerë ose cilësim, që shfaqet në anën e djathtë të ekranit. ○⋯⋯🔵: Rrotulloni çelësin rrotullues të djathtë. Lundroni nëpër vlerat dhe cilësimet e mundshme. ○⋯⋯🖱️: Shtypni çelësin rrotullues të djathtë. Konfirmoni zgjedhjen dhe shkoni në pikën tjetër të menysë.

5.2 Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për përdoruesin



Pamja e ekranit të vlerës së caktuar

(*)

Vlen vetëm kur modaliteti Operation është Quick

(**)

Mund të aksesohet vetëm nga instaluesi

(***)

Vlen vetëm kur është instaluar Wi-Fi




INFORMACION

Në varësi të cilësimeve të zgjedhura për instaluesin dhe të llojit të njësisë, cilësimet mund të jenë të dukshme/të padukshme.

5.3 Pamjet e mundshme të ekranit: Përmbledhje


Pamjet më të zakonshme të ekranit janë si më poshtë:



- a** Ekran kryesor
- b** Pamja e menysë kryesore
- c** Pamjet e ekranit të niveleve më të poshtme:
 - c1:** Pamja e ekranit të vlerës së caktuar
 - c2:** Pamja e detajuar e ekranit me vlerat
 - c3:** Pamja e ekranit me kurbën në varësi të motit
 - c4:** Pamja e ekranit me programin

5.3.1 Ekran kryesor

Shtypni butonin për t'u kthyer në ekranin kryesor. Ju mund të shihni një përmbledhje të konfigurimit të njësisë dhe të temperaturës së dhomës dhe të temperaturës së vlerës së caktuar. Në ekranin kryesor janë të dukshme vetëm simbolet e zbatueshme për konfigurimin tuaj.




Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes listës së menysë kryesore.
	Shkoni tek ekrani i menysë kryesore.

Veprimet e mundshme në ekran		
?		Aktivizoni/çaktivizoni pemët e lundrimit.
Artikulli	Përshkrimi	
a	Uji i ngrohtë sanitar	
a1		Uji i ngrohtë sanitar
a2		Temperatura e matur e depozitës ^(a)
b	Dezinfektimi / I fuqishëm	
		Modaliteti i dezinfektimit aktiv
		Modaliteti i funksionimit të fuqishëm aktiv
c	Emergjencia	
		Prishje e pompës së nxehtësisë dhe sistemi punon në modalitetin Emergjencia .
d	Data dhe ora aktuale	
e	Modaliteti Jashtë / i qetë	
e1		Temperatura e jashtme e matur ^(a)
e2		Modaliteti i qetë aktiv
e3		Njësia e jashtme
f	Njësia e brendshme / depozita e ujit të ngrohtë sanitar	
f		Depozita e ujit të ngrohtë sanitar
g	Modaliteti i pushimeve	
		Modaliteti i pushimeve aktiv
h	Defekt	
		Ka ndodhur një defekt.
		Shihni "8.1 Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti" [► 45] për më shumë informacion.

^(a) Nëse funksioni përkatës nuk është aktiv, rrethi është në ngjyrë gri.

5.3.2 Pamja e menysë kryesore

Duke u nisur nga ekrani kryesor, shtypni (🖱️) ose rrotulloni (🌀) çelësin rrotullues të majtë për të hapur ekranin e menysë kryesore. Nga menya kryesore, mund të hyni në ekranet e vlerave të caktuara të ndryshme dhe në nënmeny.



a Nënmenyja e zgjedhur

Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes listës.
	Hyni në nënmeny.
	Aktivizoni/çaktivizoni pemët e lundrimit.


Nënmenyja	Përshkrimi
[0]  ose  Defektet	Kufizim: Shfaqet vetëm nëse ndodh ndonjë defekt. Shihni "8.1 Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti" [▶ 45] për më shumë informacion.
[5]  Depozita	Vendosni temperaturën e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar.
[7]  Cilësimet për përdoruesin	Mundëson hyrjen te cilësimet për përdoruesin, si për shembull modaliteti i pushimeve dhe modaliteti i qetësisë.
[8]  Informacion	Shfaq të dhëna dhe informacione rreth njësisë së brendshme.
[9]  Cilësimet për instaluesin	Kufizim: Vetëm për instaluesin. Mundëson hyrjen te cilësimet e avancuara.
[A]  Vënia në përdorim	Kufizim: Vetëm për instaluesin. Kryen testimet dhe mirëmbajtjen.
[B]  Profili i përdoruesit	Ndryshoni profilin aktiv të përdoruesit.
[C]  Funksionimi	Ndizni dhe fikni funksionin e ngrohjes/ftohjes dhe të përgatitjes së ujit të ngrohtë sanitar.
[D]  Ruter me valë	Kufizim: Shfaqet vetëm nëse është instaluar një LAN me valë (Wi-Fi). Përmban cilësimet që nevojiten kur konfigurohet aplikacioni ONECTA. Shihni manualin referencë për përdoruesin për më shumë informacion.

5.3.3 Pamja e ekranit të vlerës së caktuar


Pamja e ekranit të vlerës së caktuar shfaqet për ekranet që përshkruajnë komponentët e sistemit që kanë nevojë për një vlerë të caktuar.

Shembull

[5] Pamja e ekranit e temperaturës së depozitës




Shpjegimi



Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes listës së nënmenysë.
	Shkoni te nënmenyja.
	Rregulloni dhe aplikoni automatikisht temperaturën e dëshiruar.


Artikulli	Përshkrimi	
Kufiri i temperaturës minimale	a1	I fiksuar nga njësia
	a2	I kufizuar nga instaluesi
Kufiri i temperaturës maksimale	b1	I fiksuar nga njësia
	b2	I kufizuar nga instaluesi
Temperatura aktuale	c	E matur nga njësia
Temperatura e dëshiruar	d	Rrotulloni çelësin rrotullues të djathtë për ta rritur/ulur (për modalitetin Vetëm ringrohje).
Nënmenyja	e	Rrotulloni ose shtypni çelësin rrotullues të majtë për të shkuar te nënmenyja.

5.3.4 Pamja e detajuar e ekranit me vlerat



- a** Cilësimet
- b** Vlerat
- c** Cilësimi i zgjedhur dhe vlera

Shembull:




Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes listës së cilësimeve.
	Ndryshoni vlerën.
	Shkoni te cilësimi tjetër.
	Konfirmoni ndryshimet dhe vazhdoni më tej.

5.4 Ndezja dhe fikja e funksionimit

5.4.1 Tregimi vizual

Disa funksione të njësise mund të aktivizohen ose të çaktivizohen më vete. Nëse një funksion çaktivizohet, ikona përkatëse e temperaturës në ekranin kryesor do të kthehet në ngjyrë gri.

Funksionimi i ngrohjes së depozitës



a Funksionimi i depozitës Ndezur
b Funksionimi i depozitës Fikur

5.4.2 Për ta ndezur ose për ta fikur

Funksionimi i ngrohjes së depozitës



NJOFTIM

Modaliteti i dezinfektimit. Edhe nëse e fikni funksionin e ngrohjes së depozitës ([C.3]: Funksionimi > Depozita), modaliteti i dezinfektimit do të mbetet aktiv. Megjithatë, nëse e fikni atë kur dezinfektimi është në proces, ndodh një gabim AH.

1	Shkoni te [C.3]: Funksionimi > Depozita.	
2	Vendoseni funksionimin në Ndezur ose Fikur.	

5.5 Leximi i informacionit

Për të lexuar informacionin

1	Shkoni te [8]: Informacion.	
----------	-----------------------------	--

Informacioni i mundshëm për lexim

Në meny...	Ju mund të lexoni...
[8.2] Historia e defekteve	Historia e defekteve
[8.3] Informacioni i shitësit	Numri i kontaktit/sportelit të ndihmës
[8.4] Sensorët	Temperatura e jashtme, Temperatura e depozitës.

Në meny...	Ju mund të lexoni...
[8.5] Aktuatorët	Statusi/modaliteti i çdo aktuatori Booster heater
[8.6] Modalitetet e funksionimit	Modaliteti aktual i funksionimit Shembull: Modaliteti shkrirje/kthimi i vajit
[8.7] Rreth	Informacioni i versionit të sistemit
[8.8] Statusi i lidhjes	Informacioni rreth statusit të lidhjes së njësisë, termostatit të dhomës dhe Wi-Fi.
[8.9] Orët e punës	Orët e punës së komponentëve specifike të sistemit

5.6 Kontrolli i ujit të ngrohtë sanitar

5.6.1 Rreth kontrollit të ujit të ngrohtë sanitar

Në varësi të modalitetit të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar (cilësim i instaluesit), ju mund të përdorni një kontroll të ndryshëm të ujit të ngrohtë sanitar:

- Vetëm ringrohje
- Programi + ringrohje
- Vetëm programi



INFORMACION

Nëse shfaqet kodi i gabimit AH dhe nuk ka pasur asnjë ndërprerje të funksionit të dezinfektimit si rezultat i marrjes së ujit të ngrohtë sanitar nga çezma, rekomandohen veprimet e mëposhtme:

- Nëse zgjidhet modaliteti **Vetëm ringrohje** ose **Programi + ringrohje**, rekomandohet të programoni nisjen e funksionit të dezinfektimit të paktën 4 orë më vonë sesa tërheqja më e madhe e fundit e pritshme e ujit të ngrohtë në çezma. Kjo nisje mund të caktohet në cilësimet për instaluesin (funksioni i dezinfektimit).
- Nëse zgjidhet modaliteti **Vetëm programi**, rekomandohet të programoni veprimin **Ekonomik** 3 orë përpara nisjes së programuar të funksionit të dezinfektimit, për të nxehur paraprakisht depozitën.

Nëse për depozitën zgjidhet funksionimi në varësi të motit, temperatura e synuar e depozitës përcaktohet automatikisht nga temperatura e jashtme. Për më shumë informacion, shihni "5.8 Kurba në varësi të motit" [▶ 32].

Për të përcaktuar se cilin modalitet të ujit të ngrohtë sanitar po përdorni (metoda 1)

Kontrolloni tabelën e cilësime për instaluesin të plotësuar nga instaluesi.

Për të përcaktuar se cilin modalitet të ujit të ngrohtë sanitar po përdorni (metoda 2)


1	Shkoni te [5]: Depozita.	
---	--------------------------	--

2	Kontrolloni se cilat pika janë të shfaqura aty:	●○○○
[5.1]	Funksioni i fuqishëm	
[5.2]	Vlera e caktuar e komfortit	
[5.3]	Vlera e caktuar ekonomike	
[5.4]	Vlera e caktuar e ringrohjes	
[5.5]	Programi	

Nëse është shfaqur...	Atëherë modaliteti i depozitës së DHW =...
Vetëm [5.1] Funksioni i fuqishëm	Vetëm ringrohje
Janë shfaqur të gjitha pikat përveç [5.4] Vlera e caktuar e ringrohjes	Vetëm programi
Janë shfaqur të gjitha pikat përfshirë [5.4] Vlera e caktuar e ringrohjes	Programi + ringrohje

5.6.2 Modaliteti i ringrohjes

Në modalitetin e ringrohjes, depozita e ujit të ngrohtë sanitar nxehet deri në temperaturën që tregohet në ekranin kryesor (për shembull: 50°C) kur temperatura bie nën një vlerë të caktuar.



INFORMACION

Nëse programi i prioritetit është vendosur te DHW (shihni "[5.9 Programi i prioritetit](#)" ► 36) dhe në të njëjtën kohë modaliteti i depozitës së DHW është ringrohje, rreziku për mungesë kapaciteti dhe probleme në komfort është i konsiderueshëm. Në rastin e funksionimit të shpeshtë të ringrohjes, funksioni ngrohje/ftohje i ajrit të kondicionuar ndërpritet rregullisht.




INFORMACION

Aplikimi i histerezisë (sasia e rënies së temperaturës që do të aktivizojë nxehjen) mund të luhatet në varësi të faktit nëse temperatura e synuar është brenda diapazonit të funksionimit të njësisë së jashtme. Konsultohuni me instaluesin.

5.6.3 Modaliteti i programuar

Në modalitetin e programuar, depozita e ujit të ngrohtë sanitar prodhon ujë të ngrohtë sipas një programi. Koha më e lirë për të lejuar depozitën të prodhojë ujin e ngrohtë është gjatë natës, sepse kërkesa për ajër të kondicionuar është më e ulët.

Shembull:




- Në fillim, temperatura e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar është njëjloj si temperatura e ujit sanitar që hyn në depozitën e ujit të ngrohtë sanitar (për shembull: **15°C**).
- Në orën 00:00 depozita e ujit të ngrohtë sanitar programohet që ta nxehë ujin deri në një vlerë të paracaktuar (për shembull: **Komforti = 60°C**).
- Gjatë mëngjesit, ju mund të konsumoni ujë të ngrohtë dhe temperatura e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar ulet.
- Në orën 14:00 depozita e ujit të ngrohtë sanitar programohet që ta nxehë ujin deri në një vlerë të paracaktuar (për shembull: **Ekonomik = 50°C**). Uji i ngrohtë do të jetë sërish në dispozicion.
- Gjatë pasdites dhe mbrëmjes, ju mund të konsumoni përsëri ujë të ngrohtë dhe temperatura e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar ulet përsëri.
- Në orën 00:00 të ditës pasardhëse, cikli përsëritet.

5.6.4 Modaliteti i programuar + ringrohje

Në modalitetin e programuar + ringrohje, kontrolli i ujit të ngrohtë sanitar është i njëjtë si në modalitetin e programuar. Megjithatë, kur temperatura e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar bie nën një vlerë të paracaktuar (=temperatura e ringrohjes e depozitës – vlera e histerezisë; shembull: 35°C), depozita e ujit të ngrohtë sanitar nxehet derisa të arrijë vlerën e caktuar të ringrohjes (për shembull: 45°C). Kjo garanton që në çdo kohë të ketë në dispozicion një sasi minimale uji të ngrohtë.

Shembull:




INFORMACION

Aplikimi i histerezisë (sasia e rënies së temperaturës që do të aktivizojë nxehjen) mund të luhatet në varësi të faktit nëse temperatura e synuar është brenda diapazonit të funksionimit të njësisë së jashtme. Konsultohuni me instaluesin.

5.6.5 Për të ndryshuar temperaturën e ujit të ngrohtë sanitar

Në modalitetin **Vetëm ringrohje**, mund të përdorni ekranin e vlerës së caktuar të depozitës për të lexuar dhe për të rregulluar temperaturën e ujit të ngrohtë sanitar.

1	Shkoni te [5]: Depozita .	
2	Rregulloni temperaturën e ujit të ngrohtë sanitar.  a Temperatura aktuale e ujit të ngrohtë sanitar b Temperatura e dëshiruar e ujit të ngrohtë sanitar	

Në modalitetet e tjera ju vetëm mund ta shihni ekranin e vlerës së caktuar, por nuk mund ta modifikoni atë. Në vend të saj, mund të modifikoni cilësimet për **Vlera e caktuar e komfortit** [5.2], **Vlera e caktuar ekonomike** [5.3] dhe **Vlera e caktuar e ringrohjes** [5.4].

Nëse për depozitën zgjidhet funksionimi në varësi të motit, temperatura e synuar e depozitës përcaktohet automatikisht nga temperatura e jashtme. Për më shumë informacion, shihni "**5.8 Kurba në varësi të motit**" [► 32].

5.6.6 Përdorimi i funksionimit të fuqishëm të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar

Rreth funksionimit të fuqishëm**Për të kontrolluar nëse funksionimi i fuqishëm është aktiv**

Nëse në ekranin kryesor është shfaqur , funksionimi i fuqishëm është aktiv.

Aktivizoni ose çaktivizoni **Funksioni i fuqishëm** si më poshtë:

1	Shkoni te [5.1]: Depozita > Funksioni i fuqishëm	
2	Vendosni funksionimin e fuqishëm në Fikur ose Ndezur .	

Shembull përdorimi: juve ju nevojitet menjëherë ujë i ngrohtë

Jeni në rrethanën e mëposhtme:

- Keni konsumuar shumicën e ujit të ngrohtë sanitar.
- Nuk mund të pritni deri në veprimin e programuar të radhës për të nxehur depozitën e ujit të ngrohtë sanitar.

Atëherë mund të aktivizoni funksionimin e fuqishëm. Depozita e ujit të ngrohtë sanitar do të fillojë ta nxehë ujin deri në temperaturën e **Komforti**.

**INFORMACION**

Nëse programi i prioritetit është vendosur te DHW (shihni "[5.9 Programi i prioritetit](#)" ► 36]) dhe funksionimi i fuqishëm është aktiv, rreziku i problemeve të ajrit të kondicionuar (ngrohje/ftohje) dhe i komfortit nga mungesa e kapacitetit është i konsiderueshëm. Në rastin e përdorimit të shpeshtë të ujit të ngrohtë sanitar, do të ndodhin ndërprerje të shpeshta dhe të gjata të ajrit të kondicionuar (ngrohje/ftohje).

Funksioni i fuqishëm mundëson që prodhimi i ujit të ngrohtë sanitar të ndihmohet nga rezistenca përforcuese. Përdorni këtë modalitet në ditët kur ka përdorim më të madh të ujit të ngrohtë sesa zakonisht.

5.7 Vlerat e paracaktuara dhe programet

5.7.1 Përdorimi i vlerave të paracaktuara

Rreth vlerave të paracaktuara

Për disa cilësime në sistem, ju mund të vendosni vlera të paracaktuara. Juve ju nevojitet që t'i vendosni këto vlera të paracaktuara vetëm një herë, e më pas t'i ripërdorni këto vlera në ekranet e tjera, si për shembull ekrani i programimit. Nëse dëshironi ta ndryshoni më vonë vlerën, ju duhet ta bëni këtë gjë vetëm në një vend.

Vlerat e paracaktuara të mundshme

Ju mund të vendosni vlerat e paracaktuara të mëposhtme që konfigurohen nga përdoruesi:

Vlera e paracaktuar		Ku përdoret
Temperatura e synuar e depozitës, Modaliteti i funksionimit , Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë	[5.2] Vlera e caktuar e komfortit	Ju mund t'i përdorni këto vlera të paracaktuara te [5.5] Programi (ekrani i programit javor për depozitën e DHW), nëse modaliteti i depozitës së DHW është një nga modalitetet më poshtë: ▪ Vetëm programi ▪ Programi + ringrohje
	[5.3] Vlera e caktuar ekonomike	
	[5.4] Vlera e caktuar e ringrohjes	Softueri përdor këtë vlerë të paracaktuar nëse modaliteti i depozitës së DHW është Programi + ringrohje
	[5.G] Modaliteti i funksionimit	Ju mund të zgjidhni dy lloje të përdorimit të ujit të ngrohtë sanitar, që lidhet me lejimin e rezistencës përforcuese: ▪ Efikas ▪ I shpejtë
	[5.H] Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë	Ky kohëmatës hyn në punë vetëm nëse opsioni " I shpejtë " zgjidhet si Modaliteti i funksionimit . Mund të zgjidhen tre kohëmatës të paracaktuara: ▪ Turbo (10 minuta) ▪ Normal (20 minuta) ▪ Ekonomik (30 minuta)

Përveç vlerave të paracaktuara që konfigurohen nga përdoruesi, sistemi përmban edhe disa vlera të paracaktuara që përcaktohen nga sistemi, të cilat mund t'i përdorni kur programoni programet.

Shembull: Te [7.4.2] **Cilësimet për përdoruesin > I qetë > Programi** (programi javor për rastin kur njësia duhet të përdorë një nga nivelet e modalitetit të qetësisë), ju mund të përdorni vlerat e paracaktuara të mëposhtme të përcaktuara nga sistemi: **I qetë/Më i qetë/Më i qetë**.

5.7.2 Përdorimi dhe programimi i programeve

Rreth programeve

Në varësi të ndërtimit të sistemit dhe të konfigurimit nga instaluesi, mund të ofrohen programe për disa kontrolle.

Ju mund të...	Shihni...
Vendosni nëse një kontroll specifik duhet të hyjë në veprim sipas një programi.	" Ekrani i aktivizimit " te " Programet e mundshme " [▶ 27]
Zgjidhni se cilin program dëshironi të përdorni aktualisht për një kontroll specifik. Sistemi përmban disa programe të parapërcaktuara. Ju mund të:	

Ju mund të...	Shihni...
Konsultohuni se cili program është zgjedhur aktualisht.	"Programi/Kontrolli" te "Programet e mundshme" [▶ 27]
Programoni programet tuaja individuale nëse programet e parapërcaktuara nuk janë sipas dëshirave tuaja. Veprimet që mund të programoni janë specifike sipas kontrollit.	"Veprimet e mundshme" te "Programet e mundshme" [▶ 27] "5.7.3 Ekran i programit: Shembull ilustrues" [▶ 28]

Programet e mundshme

Tabela përmban informacionin e mëposhtëm:

- **Programi/Kontrolli:** Kjo kolonë tregon se ku mund të konsultoheni për programin e zgjedhur aktualisht, për kontrollin specifik. Nëse nevojitet, ju mund të:
 - Programoni programet tuaja individuale. Shihni "5.7.3 Ekran i programit: Shembull ilustrues" [▶ 28].
- **Programet e parapërcaktuara:** (nëse ka) Programet e parapërcaktuara në sistem për kontrollin specifik. Nëse nevojitet, mund të programoni programet tuaja individuale.
- **Ekran i aktivizimit:** Për shumicën e kontrolleve, një program është efektiv vetëm nëse ai aktivizohet në ekranin e tij përkatës të aktivizimit. Kjo pikë ju tregon se ta aktivizoni atë.
- **Veprimet e mundshme:** Veprimet që mund të përdorni kur programoni një program.

Programi/Kontrolli	Përshkrimi
[5.5] Depozita > Programi Programi për temperaturën e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar, për nevojat tuaja normale për ujë të ngrohtë sanitar.	Programet e parapërcaktuara: Nuk përdoret Ekran i aktivizimit: Nuk përdoret. Ky program aktivizohet automatikisht nëse modaliteti i DHW është një nga modalitetet më poshtë: ▪ Vetëm programi ▪ Programi + ringrohje Veprimet e mundshme: ▪ Komforti: Kur të fillojë ngrohja e depozitës në vlerën e paracaktuar të konfiguruar nga përdoruesi [5.2] Vlera e caktuar e komfortit. ▪ Ekonomik: Kur të fillojë ngrohja e depozitës në vlerën e paracaktuar të konfiguruar nga përdoruesi [5.3] Vlera e caktuar ekonomike. ▪ Ndalo: Kur të ndalojë ngrohja e depozitës, edhe nëse temperatura e dëshiruar e depozitës nuk është arritur ende. Shënim: Në modalitetin Programi + ringrohje, sistemi merr gjithashtu parasysh vlerën e paracaktuar të konfiguruar nga përdoruesi [5.4] Vlera e caktuar e ringrohjes.


Programi/Kontrolli	Përshkrimi
[5.F] Depozita > Programi i prioritetit Program për njësinë e jashtme, për të përcaktuar prioritetin midis funksionimit të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar dhe ajrit të kondicionuar	Programet e parapërcaktuara: Uji i ngrohtë sanitar si prioritet për çdo muaj Ekrani i aktivizimit: Nuk përdoret. Ky program përdoret vetëm kur në njësinë e jashtme është lidhur më shumë se një njësi e brendshme (p.sh. 1 depozitë + njësi 1 A/C). Veprimet e mundshme: ▪ DHW : Nëse ka njëkohësisht kërkesa nga disa njësi të brendshme, njësia e jashtme do t'i japë prioritet prodhimit të ujit të ngrohtë sanitar. ▪ A/C : Nëse ka njëkohësisht kërkesa nga disa njësi të brendshme, njësia e jashtme do t'i japë prioritet funksionimit të ajrit të kondicionuar (ngrohje/ftohje).
[7.4.2] Cilësimet për përdoruesin > I qetë > Programi Program për rastin kur njësia duhet të përdorë një nga nivelet e modalitetit të qetësisë.	Programi i parapërcaktuar: Nuk përdoret Ekrani i aktivizimit: [7.4.1] Modaliteti (ofrohet vetëm për instaluesit). Veprimet e mundshme: Ju mund të përdorni vlerat e paracaktuara të mëposhtme të përcaktuara nga sistemi: ▪ Fikur ▪ I qetë ▪ Më i qetë ▪ Më i qeti Shihni "Rreth modalitetit të qetë" [► 38].

5.7.3 Ekrani i programit: Shembull ilustrues

Ky shembull ju tregon si të vendosni një program për nxehjen e depozitës.

Për të programuar programin: përmbledhje

Shembull: Ju dëshironi të programoni programin e mëposhtëm:





- 1 Shkoni te programi.
- 2 (opsionale) Pastroni përmbajtjen e programit për të gjithë javën ose përmbajtjen e programit për një ditë të zgjedhur.
- 3 Programoni programin për ditën **E hënë**.
- 4 Kopjoni programin në ditët e tjera të javës.
- 5 Programoni programin për ditën **E shtunë** dhe kopjojeni atë në ditën **E diel**.


Për të shkuar te programi

1	Shkoni te [5.5]: Depozita > Programi.	
---	---------------------------------------	---


Për të pastruar përmbajtjen e programit javor


1	Zgjidhni emrin e programit aktual. 	
2	Zgjidhni Fshi. 	
3	Zgjidhni OK për ta konfirmuar.	

Për të pastruar përmbajtjen e programit të një dite



1	Zgjidhni ditën për të cilën dëshironi të pastroni përmbajtjen. Për shembull E premte 	
2	Zgjidhni Fshi. 	
3	Zgjidhni OK për ta konfirmuar.	



Për të programuar programin për ditën E hënë

1	Zgjidhni E hënë. 	
2	Zgjidhni Modifiko. 	



3	Përdorni çelësin rrotullues të majtë për të zgjedhur një pikë dhe modifikoni pikën me çelësin rrotullues të djathtë. Mund të programoni deri në 4 veprime çdo ditë.  Shënim: Për të pastruar një veprim, vendosni kohën e tij si kohë të veprimit të mëparshëm.	
4	Konfirmoni ndryshimet. Rezultati: Përcaktohet programi për ditën e hënë. Vlera e veprimit të fundit është ende e vlefshme deri në veprimin e ardhshëm të programuar. Në këtë shembull, Monday/E hënë është dita e parë që keni programuar. Në këtë mënyrë, veprimi i fundit i programuar është i vlefshëm deri në veprimin e parë të së hënës së ardhshme.	

Për të kopjuar programin në ditët e tjera të javës

1	Zgjidhni E hënë. 	
2	Zgjidhni Kopjo.  Rezultati: Ngjitur me ditën e kopjuar shfaqet "C".	
3	Zgjidhni E martë. 	

4	Zgjidhni Ngjit.  Rezultati: 	
5	Përsëritni këtë veprim për të gjitha ditët e tjera të javës. 	—

Për të programuar programin për ditën E shtunë dhe për ta kopjuar atë në ditën E diel

1	Zgjidhni E shtunë.	
2	Zgjidhni Modifiko.	
3	Përdorni çelësin rrotullues të majtë për të zgjedhur një pikë dhe modifikoni pikën me çelësin rrotullues të djathtë. 	 
4	Konfirmoni ndryshimet.	
5	Zgjidhni E shtunë.	
6	Zgjidhni Kopjo.	
7	Zgjidhni E diel.	
8	Zgjidhni Ngjit. Rezultati: 	

5.8 Kurba në varësi të motit

5.8.1 Çfarë është kurba në varësi të motit?

Funksionimi në varësi të motit

Njësia funksionon "në varësi të motit", nëse temperatura e dëshiruar e përcaktuar përcaktohet automatikisht nga temperatura e jashtme. Nëse temperatura e jashtme bie ose rritet, njësia kompenson në moment. Në këtë mënyrë, njësia nuk i duhet të presë reagimin nga përdoruesi për të rritur ose për të ulur temperaturën e synuar të depozitës. Meqë ajo reagon më shpejt, kjo parandalon rritjet dhe rëniet e larta të temperaturës së ujit në rubineta.

Avantazhi

Funksionimi në varësi të motit zvogëlon konsumin e energjisë.

Kurba në varësi të motit

Që të jetë në gjendje të kompensojë diferencat në temperaturë, njësia mbështetet në kurbën e saj në varësi të motit. Kjo kurbë përcakton sesa e madhe duhet të jetë diferenca midis temperaturës së synuar të depozitës dhe temperaturave të jashtme. Meqenëse pjerrësia e kurbës varet nga rrethanat lokale të tilla si klima dhe izolimi i shtëpisë, kurba mund të përshtatet nga instaluesi.

Llojet e kurbës në varësi të motit

Ekzistojnë 2 lloje të kurbave në varësi të motit:

- Kurba me 2 pika
- Kurba pjerrësi-kompensim

Lloji i kurbës në të cilën dëshironit të bëni rregullime varet nga preferencat personale. Shihni "[5.8.4 Përdorimi i kurbave në varësi të motit](#)" [▶ 34].

Disponueshmëria

Kurba në varësi të motit disponohet për:

- Depozitën (ofrohet vetëm për instaluesit)




INFORMACION

Që funksionimi në varësi të motit të funksionojë, konfiguroni saktë vlerën e caktuar të depozitës. Shihni "[5.8.4 Përdorimi i kurbave në varësi të motit](#)" [▶ 34].

5.8.2 Kurba me 2 pika

Përcaktoni kurbën në varësi të motit me këto dy vlera të caktuara:

- Vlera e caktuar (X1, Y2)
- Vlera e caktuar (X2, Y1)

Shembull

Artikulli	Përshkrimi
X1, X2	Shembuj të temperaturës së jashtme të ambientit
Y1, Y2	Shembuj të temperaturës së dëshiruar të depozitës. Ikona korrespondon me emetuesin e nxehtësisë për atë zonë: Depozita e ujit të ngrohtë sanitar

Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes temperaturave.
	Ndryshoni temperaturën.
	Shkoni në temperaturën tjetër.
	Konfirmoni ndryshimet dhe vazhdoni më tej.

5.8.3 Kurba pjerrësi-kompensim


Pjerrësia dhe kompensimi

Përcaktoni kurbën në varësi të motit në varësi të pjerrësisë së saj dhe kompensimit:


- Ndryshoni **pjerrësinë** për të rritur ose për të ulur në mënyrë të ndryshme temperaturën e synuar të depozitës për temperatura ambientit të ndryshme. Për shembull, nëse temperatura e ujit të depozitës në përgjithësi është shumë e mirë, por në temperatura ambientit të ulëta ajo është shumë e ftohtë, rritni pjerrësinë në mënyrë që temperatura e depozitës të nxehet më shumë në temperatura ambientit që ulen më shumë.
- Ndryshoni **kompensimin** për të rritur ose për të ulur njëllë temperaturën e synuar të depozitës për temperatura ambientit të ndryshme. Për shembull, nëse temperatura e depozitës është gjithmonë pak si e ftohtë për temperatura ambientit të ndryshme, ndryshoni kompensimin më lart, për ta rritur njëllë temperaturën e synuar të depozitës për të gjitha temperaturat e ambientit.

Shembuj

Kurba në varësi të motit kur zgjidhet pjerrësia:



Kurba në varësi të motit kur zgjidhet kompensimi:



Artikulli	Përshkrimi
a	Kurba në varësi të motit përpara ndryshimeve.
b	Kurba në varësi të motit pas ndryshimeve (si shembull): - Kur ndryshohet pjerrësia, temperatura e re e preferuar në X1 është në mënyrë jo të barabartë më e lartë sesa temperatura e preferuar në X2. - Kur ndryshohet kompensimi, temperatura e re e preferuar në X1 është njëlloj më e lartë si temperatura e preferuar në X2.
c	Pjerrësia
d	Kompensimi
X1, X2	Shembuj të temperaturës së jashtme të ambientit
Y1, Y2, Y3, Y4	Shembuj të temperaturës së dëshiruar të depozitës. Ikona korrespondon me emetuesin e nxehtësisë për atë zonë: : Depozita e ujit të ngrohtë sanitar

Veprimet e mundshme në ekran	
	Zgjidhni pjerrësinë ose kompensimin.
	Rritni ose ulni pjerrësinë/kompensimin.
	Kur zgjidhet pjerrësia: vendosni pjerrësinë dhe shkoni te kompensimi. Kur zgjidhet kompensimi: vendosni kompensimin.
	Konfirmoni ndryshimet dhe kthehuni te nënmenyja.

5.8.4 Përdorimi i kurbave në varësi të motit

Konfiguroni kurbat në varësi të motit si më poshtë:

Për të përcaktuar modalitetin e vlerës së caktuar

Për të përdorur kurbën në varësi të motit, juve ju duhet të përcaktoni modalitetin e saktë të vlerës së caktuar:

Shkoni në modalitetin e vlerës së caktuar...	Vendosni modalitetin e vlerës së caktuar në...
Depozita	
[5.B] Depozita > Modaliteti i vlerës së caktuar	Kufizim: Ofrohet vetëm për instaluesit. Në varësi të motit

Për të ndryshuar llojin e kurbës në varësi të motit

Për të ndryshuar llojin për depozitën, shkoni te [5.E] Depozita.

- [5.E] Depozita > Lloji i kurbës në varësi të motit

Kufizim: Ofrohet vetëm për instaluesit.

Për të ndryshuar kurbën në varësi të motit

Zona	Shkoni te...
Depozita	Kufizim: Ofrohet vetëm për instaluesit. [5.C] Depozita > Kurba në varësi të motit



INFORMACION

Vlerat e caktuara maksimale dhe minimale

Ju nuk mund ta konfiguroni kurbën me temperatura që janë më të larta ose më të ulëta se vlerat e caktuara maksimale dhe minimale, të vendosura për depozitën. Kur arrihet vlera e caktuar maksimale ose minimale, kurba drejtohet.

Për akordim të imët të kurbës në varësi të motit: kurba pjerrësi-kompensim

Tabela në vijim përshkruan sesi të bëni akordimin e imët të kurbës në varësi të motit të depozitës:

Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar është...		Akordimi i imët me pjerrësinë dhe kompensimin:	
Në temperatura të jashtme normale...	Në temperatura të jashtme të ftohta...	Pjerrësia	Kompensimi
OK	Ftohtë	↑	—
OK	Nxehtë	↓	—
Ftohtë	OK	↓	↑
Ftohtë	Ftohtë	—	↑
Ftohtë	Nxehtë	↓	↑
Nxehtë	OK	↑	↓
Nxehtë	Ftohtë	↑	↓
Nxehtë	Nxehtë	—	↓

Shihni "5.8.3 Kurba pjerrësi-kompensim" [▶ 33].

Për akordim të imët të kurbës në varësi të motit: kurba me 2 pika

Tabela në vijim përshkruan sesi të bëni akordimin e imët të kurbës në varësi të motit të depozitës:

Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar është...		Akordimi i imët me vlerat e caktuara:			
Në temperatura të jashtme normale...	Në temperatura të jashtme të ftohta...	Y2 ^(a)	Y1 ^(a)	X1 ^(a)	X2 ^(a)
OK	Ftohtë	↑	—	↑	—
OK	Nxehtë	↓	—	↓	—
Ftohtë	OK	—	↑	—	↑
Ftohtë	Ftohtë	↑	↑	↑	↑

Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar është...		Akordimi i imët me vlerat e caktuara:			
Në temperatura të jashtme normale...	Në temperatura të jashtme të ftohta...	Y2 ^(a)	Y1 ^(a)	X1 ^(a)	X2 ^(a)
Ftohtë	Nxehtë	↓	↑	↓	↑
Nxehtë	OK	—	↓	—	↓
Nxehtë	Ftohtë	↑	↓	↑	↓
Nxehtë	Nxehtë	↓	↓	↓	↓

^(a) Shihni "5.8.2 Kurba me 2 pika" [▶ 32].

5.9 Programi i prioritetit

Prioriteti i ajrit të kondicionuar ose i ujit të ngrohtë sanitar

Kur në njësinë e jashtme janë lidhur disa njësi të brendshme, përdoruesi mund të caktojë në ndërfaqen e përdoruesit për çdo muaj nëse do të vendosë **DHW** ose ajrin e kondicionuar (**A/C**) si prioritet. Kjo përcakton sesi do të reagojë njësia e jashtme në rast se kërkohet funksionimi i disa njësive të brendshme në të njëjtën kohë:

- Nëse vendoset **DHW** si prioritet, njësia e jashtme mund të vendosë që të punojë kryesisht për **DHW**, kurse në sezonin e ftohjes funksioni i **A/C** ndalohet, ose në sezonin e ngrohjes, në varësi të ngarkesës së sistemit për ngrohje, funksioni i **A/C** vendoset në pritje ose balancohet. Në këtë rast, pasi funksioni i **DHW** të përfundojë ose kur ai nuk është më brenda diapazonit të funksionimit të pompës së nxehtësisë, njësia e jashtme mund të kalojë në **A/C** (ftohje ose ngrohje).
- Nëse vendoset **A/C** si prioritet, njësia e jashtme mund të vendosë të punojë vetëm për **A/C**, rast në të cilin rezistenca përforcuese mund të ndizet për të prodhuar **DHW**. Pasi funksioni i **A/C** (ftohje) fiket ose funksioni i **A/C** (ngrohje) përfundon, njësia e jashtme e pompës së nxehtësisë mund të kalojë te **DHW**.

Për të zgjedhur programin e prioritetit

1	Shkoni te [5.F]: Depozita > Programi i prioritetit.	
2	Zgjidhni se cilin muaj do të vendosni. Programi i prioritetit Janar DHW Shkurt DHW Mars DHW	
3	Zgjidhni programin e prioritetit për atë muaj. Programi i prioritetit Janar DHW Shkurt A/C Mars DHW	

Shembull i rezultateve të mundshme bazuar në programin e programuar të prioritetit janë si më poshtë:

Nëse ...			Atëherë funksionimi i pompës së nxehtësisë = ... ^(a)
Cili është prioriteti?	Kërkesa e A/C është ...	A i bën dot të dyja njësia e jashtme? ^(b)	
DHW	Ftohje	-	DHW, kurse A/C vendoset në pritje
	Ngrohje	Po	DHW dhe A/C bashkë
		Jo	DHW, kurse A/C vendoset në pritje
A/C	Ftohje	-	A/C, kurse DHW realizohet nga rezistenca përforcuese
	Ngrohje	Po	DHW dhe A/C bashkë
		Jo	A/C, kurse DHW realizohet nga rezistenca përforcuese

^(a) Zbatohet nëse kërkesat e DHW dhe A/C ndodhin në të njëjtën kohë, kur temperatura e jashtme e ambientit dhe temperatura e synuar e depozitës janë brenda diapazonit të funksionimit të njësive së jashtme.

^(b) Përcaktohet nga njësia e jashtme.



INFORMACION

Nëse rezistenca përforcuese merr gjithmonë përsipër peshën e ngrohjes së DHW për shkak të cilësimit **Programi i prioritetit** të vendosur në **A/C**, konsumi i energjisë elektrike do të jetë ndjeshëm më i lartë. Për muajt kur ngrohja/ftohja nga A/C është më pak e rëndësishme, rekomandohet ta vendosni **Programi i prioritetit** në DHW.



INFORMACION

Nëse vendoset DHW si prioritet dhe pritet përdorim i shpeshtë i DHW, ekziston rreziku i problemit me komfortin për shkak të ndërprerjes së funksionimit të A/C. Për muajt kur ngrohja/ftohja nga A/C është më e rëndësishme, rekomandohet ta vendosni **Programi i prioritetit** në A/C.

5.10 Modaliteti i funksionimit

Zgjedhja e modalitetit të funksionimit për DHW

Në varësi të faktit nëse dëshirohet përdorimi i hershëm i rezistencës përforcuese, për DHW mund të zgjidhen dy modalitete funksioni si më poshtë:

- **Efikas:** Rezistenca përforcuese lejohet vetëm kur njësia e jashtme nuk e ka të mundur të realizojë DHW (p.sh. Temperatura e ujit është diapazonit të funksionimit të njësive së jashtme, ose njësia e jashtme vendos të kryejë vetëm funksionin A/C – shihni "5.9 Programi i prioritetit" ► 36)]
- **I shpejtë:** Rezistenca përforcuese lejohet ose pasi ka kaluar një sasi e caktuar kohe që nga nisja e funksionit DHW (shih më poshtë), ose kur njësia e jashtme nuk e ka të mundur të realizojë DHW.

Kohëmatësi i modalitetit Quick

Kur zgjidhet modaliteti **I shpejtë**, përdoruesi mund të zgjedhë midis 3 kohëmatësve të paracaktuar, pas të cilit rezistenca përforcuese mund të aktivizohet pas nisjes së përdorimit të DHW:

- Turbo: 10 minuta
- Normal: 20 minuta
- Economic: 30 minuta

Kur zgjidhet modaliteti **Efikas**, Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë nuk përdoret.

**INFORMACION**

Kur dezinfektimi i depozitës kryhet me modalitetin **Efikas**, rezistenca përforcuese mund të nisët sërish pas 20 minutash për të ndihmuar pompën e nxehtësisë.

5.11 Funksionet e tjera

5.11.1 Për të konfiguruar orën dhe datën

1	Shkoni te [7.2] Cilësimet për përdoruesin > Ora/data.	
----------	---	--

5.11.2 Përdorimi i modalitetit të qetë

Rreth modalitetit të qetë

Ju mund të përdorni modalitetin e qetë për të ulur zhurmën e njësisë së jashtme. Sidoqoftë, kjo ul gjithashtu kapacitetin e sistemit në ftohje/ngrohje. Ekzistojnë disa nivele të modalitetit të qetë.

Instaluesi mund të:

- Çaktivizojë plotësisht modalitetin e qetë
- Aktivizojë manualisht një nivel të modalitetit të qetë
- Caktojë përdoruesin të programojë një program të modalitetit të qetë
- Konfigurojë kufizimet në bazë të rregulloreve lokale

Nëse caktohet nga instaluesi, përdoruesi mund të programojë një program të modalitetit të qetë.

**INFORMACION**

Nëse temperatura e jashtme është nën zero, ne rekomandojmë të MOS përdorni nivelin më të qetë.

Për të kontrolluar nëse modaliteti i qetë është aktiv

Nëse në ekranin kryesor është shfaqur , modaliteti i qetë është aktiv.

Për të programuar një program të modalitetit të qetë

Kufizim: E mundur vetëm nëse caktohet nga instaluesi.

1	Shkoni te [7.4.2]: Cilësimet për përdoruesin > I qetë > Programi.	
----------	--	--

2	Programoni programin. Veprimet e mundshme: Ju mund të përdorni vlerat e paracaktuara të mëposhtme të përcaktuara nga sistemi: ▪ Fikur ▪ I qetë ▪ Më i qetë ▪ Më i qeti Për më shumë informacion rreth programimit, shihni "5.7.2 Përdorimi dhe programimi i programeve" [▶ 26].	—
---	--	---



INFORMACION

Nëse cilësimi **Kufizimet** aktivizohet dhe konfigurohet nga instaluesi, **Programi** mund të anashkalohet nga **Kufizimet**. Për detajet konsultohuni me instaluesin.

5.11.3 Përdorimi i modalitetit të pushimeve

Rreth modalitetit të pushimeve

Gjatë pushimeve tuaja, ju mund të përdorni modalitetin e pushimeve për të devijuar nga programet normale, pa qenë nevoja t'i ndryshoni ato. Kur modaliteti i pushimeve është aktiv, funksioni i ujit të ngrohtë sanitar do të jetë i fikur. Operacioni i dezinfektimit do të mbetet aktiv.

Ngarkesa tipike e punës


Përdorimi i modalitetit të pushimeve në mënyrë tipike përbëhet nga fazat e mëposhtme:

- 1 Aktivizimi i modalitetit të pushimeve.
- 2 Vendosja e datës së fillimit dhe datës së mbarimit të pushimeve tuaja.

Për të kontrolluar nëse modaliteti i pushimeve është aktivizuar dhe/ose në punë

Nëse në ekranin kryesor është shfaqur , modaliteti i pushimeve është aktiv.

Për të konfiguruar pushimet

1	Aktivizoni modalitetin e pushimeve. ▪ Shkoni te [7.3.1]: Cilësimet për përdoruesin > Pushimet > Aktivizimi. 7.3.1 	—
	▪ Zgjidhni Ndezur.	
2	Vendosni ditën e parë të pushimeve. ▪ Shkoni te [7.3.2]: Nga. ▪ Zgjidhni një datë. ▪ Konfirmoni ndryshimet.	—   

3	Vendosni ditën e fundit të pushimeve.	—
	▪ Shkoni te [7.3.3]: Deri në .	
	▪ Zgjidhni një datë.	  
	▪ Konfirmoni ndryshimet.	

5.11.4 Përdorimi i Wi-Fi




INFORMACION

Kufizim: Cilësimet e Wi-Fi janë të dukshme vetëm kur në ndërfaqen e përdoruesit është futur një kartë e Wi-Fi.

Rreth kartës së Wi-Fi

Karta e Wi-Fi lidh sistemin me internetin. Si përdorues, ju mund ta kontrolloni më pas sistemin nëpërmjet aplikacionit ONECTA.


Kjo kërkon komponentët e mëposhtëm:



a	Karta e Wi-Fi	Karta e Wi-Fi nevojitet për t'u futur në ndërfaqen e përdoruesit.
b	Ruteri	Sigurohet në terren.
c	Smartfoni + aplikacioni	Nevojitet që aplikacioni ONECTA të instalohet në smartfonin e përdoruesit. Shihni: http://www.onlinecontroller.daikineurope.com/ 

Konfigurimi

Për të konfiguruar aplikacionin ONECTA ndiqni udhëzimet e aplikacionit. Teksa e bëni këtë, në ndërfaqen e përdoruesit nevojiten veprimet dhe informacionet e mëposhtme:



[D] Ruter me valë

[D.1] Modaliteti

[D.2] Rindiz

[D.3] WPS

[D.4] Hiq nga reja kompjuterike

[D.5] Lidhja me rrjetin e shtëpisë

[D.6] Lidhja me renë kompjuterike

[D.1] **Modaliteti**: Aktivizoni modalitetin AP (= Karta e Wi-Fi aktive si pikë akses):

1	Shkoni te [D.1]: Ruter me valë > Modaliteti .	
2	Në ekranin Aktivizo modalitetin AP , zgjidhni Po .	

[D.2] **Rindiz**: Rindizni kartën e Wi-Fi:

1	Shkoni te [D.2]: Ruter me valë > Rindiz .	
2	Në ekranin Rindiz ruterin , zgjidhni OK .	

[D.3] **WPS**: Lidhni kartën e Wi-Fi me ruterin:



INFORMACION

Ju mund ta përdorni këtë funksion vetëm nëse ai mbështetet nga versioni i softuerit i Wi-Fi dhe versioni i softuerit i aplikacionit ONECTA.

1	Shkoni te [D.3]: Ruter me valë > WPS .	
2	Në ekranin WPS , zgjidhni Po .	

[D.4] **Hiq nga reja kompjuterike**: Hiqni kartën e Wi-Fi nga reja kompjuterike:

1	Shkoni te [D.4]: Ruter me valë > Hiq nga reja kompjuterike .	
2	Në ekranin Hiq nga reja kompjuterike , zgjidhni Po .	

[D.5] **Lidhja me rrjetin e shtëpisë**: Lexoni statusin e lidhjes në rrjetin e shtëpisë:

1	Shkoni te [D.5]: Ruter me valë > Lidhja me rrjetin e shtëpisë .	
2	Lexoni statusin e lidhjes: ▪ U shkëput nga [WLAN_SSID] ▪ U lidh me [WLAN_SSID]	

[D.6] **Lidhja me renë kompjuterike**: Lexoni statusin e lidhjes në renë kompjuterike:

1	Shkoni te [D.6]: Ruter me valë > Lidhja me renë kompjuterike .	
2	Lexoni statusin e lidhjes: ▪ Jo i lidhur ▪ I lidhur	

6 Këshilla për kursimin e energjisë

Këshilla për temperaturën e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar

- Vendosni **Programi i prioritetit** në DHW për të minimizuar përdorimin e rezistencës përforcuese elektrike.
- Përdorni një program javor për nevojat tuaja normale për ujë të ngrohtë sanitar (VETËM në modalitetin e programuar).
- Gjithashtu, duke caktuar veprimin e nxehjes vetëm në veprimin e programuar, ndërprerja në funksionimin e ajrit të kondicionuar do të jetë e kufizuar në momentet e veçanta, kur kërkesa për ngrohje/ftohje nga A/C është më pak e rëndësishme.
 - Programoni që depozita e ujit të ngrohtë sanitar të nxehet në një vlerë të paracaktuar (**Komforti** = temperaturë e lartë e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar) gjatë natës, sepse kërkesa për ngrohje/ftohje nga A/C është më e ulët (për shembull: midis orës 22:00 dhe 04:00).
 - Nëse nxehja një herë gjatë natës e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar NUK mjafton, programoni një nxehje shtesë të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar në një vlerë të paracaktuar (**Ekonomik** = temperaturë e ulët e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar) gjatë ditës ose gjatë kohës kur nuk ka njeri në shtëpi (për shembull: midis orës 09:00 dhe 15:00).
- Sigurohuni që temperatura e dëshiruar e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar të MOS jetë shumë e lartë. **Shembull:** Pas montimit, ulni çdo ditë temperaturën e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar me nga 1°C dhe shihni nëse keni ende mjaftueshëm ujë të ngrohtë.

7 Mirëmbajtja dhe shërbimi

7.1 Përmbledhje: Mirëmbajtja dhe shërbimi

Instaluesi duhet të kryejë një mirëmbajtje të përvitshme. Numrin e kontaktit/sportelit të ndihmës mund ta gjeni në ndërfaqen e përdoruesit.

1	Shkoni te [8.3]: Informacion > Informacioni i shitësit.	
----------	---	---

Si përdorues fundor, ju duhet:

- Të mbani të pastër vendin përreth njësisë.
- Të pastroni ndërfaqen e përdoruesit me një leckë të butë të lagësht. Të MOS përdorni asnjë detergjent.

Gazi ftohës

Ky produkt përmban gazra serë me fluor. MOS i lësho gazrat në atmosferë.

Lloji i ftohësit: R32

Vlera e mundshme e ngrohjes globale (GWP): 675

Inspektimet periodike për rrjedhjet e ftohësit mund të kërkohen në varësi të legjislacionit në zbatim. Kontaktoni instaluesin tuaj për më shumë informacion.



ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.



PARALAJMËRIM

- Ftohësi brenda njësisë është pak i djegshëm, por normalisht NUK shkakton rrjedhje. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr ose formimin e një gazi të dëmshëm.
- FIKNI çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.
- MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.



PARALAJMËRIM

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).



PARALAJMËRIM

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.



NJOFTIM

Legjislacioni në fuqi për **gazrat serë me fluor** kërkon që ngarkimi i ftohësit të njësisë të tregohet si në peshë ashtu edhe në ekuivalentin CO₂.

Formula për të llogaritur sasinë në tonet ekuivalente të CO₂: Vlera GWP e ftohësit × Ngarkesa totale e ftohësit [në kg] / 1000

Kontakttoni instaluesin tuaj për më shumë informacion.

8 Zgjidhja e problemeve

Kontakti

Për simptomat e renditura më poshtë, mund të provoni ta zgjidhni vetë problemin. Për çdo problem tjetër, kontaktoni me instaluesin. Numrin e kontaktit/sportelit të ndihmës mund ta gjeni në ndërfaqen e përdoruesit.

1	Shkoni te [8.3]: Informacion > Informacioni i shitësit.	
---	---	---

8.1 Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti

Në rast defekti, në ekranin kryesor shfaqet një nga opsionet në vijim, në varësi të ashpërsisë:

- : Gabim
- : Defekt

Mund të merrni një përshkrim të shkurtër dhe një përshkrim të gjatë të defektit, si më poshtë:

1	Shtypni çelësin rrotullues të majtë për të hapur menyne kryesore dhe shkoni te Defektet . Rezultati: Në ekran shfaqet një përshkrim i shkurtër i gabimit dhe kodi i gabimit.	
2	Shtypni ? në ekranin e gabimit. Rezultati: Në ekran shfaqet një përshkrim i gjatë i gabimit.	?



PARALAJMËRIM

Në rastin e kodit të gabimit F3-00, ekziston rreziku i mundshëm për rrjedhje të gazit ftohës. Kontaktoni me instaluesin.

8.2 Për të kontrolluar historinë e defekteve

Kushtet: Niveli i autorizimit të përdoruesit është i caktuar te përdoruesi i avancuar.

1	Shkoni te [8.2]: Informacion > Historia e defekteve.	
---	--	---

Do të shihni një listë me defektet më të fundit.

8.3 Simptoma: Uji në çezmë është shumë i ftohtë

Shkaku i mundshëm	Veprimi korrigjues
Keni harxhuar të gjithë ujin e ngrohtë sanitar për shkak të konsumit të lartë të pazakontë.	Nëse ju nevojitet menjëherë ujë i ngrohtë, aktivizoni Funksioni i fuqishëm të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar. Megjithatë, kjo konsumon energji shtesë. Shihni "5.6.6 Përdorimi i funksionimit të fuqishëm të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar" [▶ 24].
Temperatura e dëshiruar e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar është shumë e ulët.	Nëse problemi përsëritet çdo ditë, veproni si më poshtë: ▪ Rritni vlerën e paracaktuar të temperaturës së depozitës së ujit të ngrohtë sanitar. Shihni "5.7.1 Përdorimi i vlerave të paracaktuara" [▶ 25]. ▪ Rregulloni programin e temperaturës së depozitës së ujit të ngrohtë sanitar. Shembull: Programoni të nxehni shtesë depozitën e ujit të ngrohtë sanitar në një vlerë të paracaktuar (Vlera e caktuar ekonomike = temperaturë e ulët e depozitës) gjatë ditës. Shihni "5.7.2 Përdorimi dhe programimi i programeve" [▶ 26] dhe "5.7.3 Ekrani i programit: Shembull ilustrues" [▶ 28].

8.4 Simptoma: Prishja e pompës së nxehtësisë

Kur pompa e nxehtësisë nuk punon, rezistenca përforcuese mund të shërbejë si ngrohëse emergjence. Pas kësaj ajo merr përsipër peshën e ngrohjes ose automatikisht, ose përmes ndërhyrjes manuale.

- Kur **Emergjencia** është vendosur në **Automatike** dhe ndodh një prishje/defekt i pompës së nxehtësisë, rezistenca përforcuese në depozitë merr përsipër automatikisht prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar.
- Nëse **Emergjencia** është vendosur në **Manuale** dhe ndodh një prishje/defekt i pompës së nxehtësisë, nxehja e ujit të ngrohtë sanitar ndalon.

Për ta rikuperuar manualisht përmes ndërfaqes së përdoruesit, shkoni në ekranin e menysë kryesore **Defektet** dhe konfirmoni nëse rezistenca përforcuese mund ta marrë përsipër ose jo peshën e ngrohjes.

Kur pompa e nxehtësisë prishet,  ose  do të shfaqet në ndërfaqen e përdoruesit.

Shkaku i mundshëm	Veprimi korrigjues
Pompa e nxehtësisë është dëmtuar.	Shihni "8.1 Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti" [▶ 45].

**INFORMACION**

Kur rezistenca përforcuese merr përsipër peshën e ngrohjes, konsumi i energjisë elektrike do të jetë ndjeshëm më i lartë.

9 Ndryshimi i vendndodhjes

9.1 Përmbledhje: Ndryshimi i vendndodhjes

Nëse dëshironi të zhvendosni pjesët e sistemit, kontaktoni me instaluesin. Numrin e kontaktit/sportelit të ndihmës mund ta gjeni në ndërfaqen e përdoruesit.

1	Shkoni te [8.3]: Informacion > Informacioni i shitësit.	
----------	---	---

10 Hedhja

**NJOFTIM**

MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET të përputhet me legjislacionin në fuqi. Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim.

11 Fjalor

DHW = Ujë i nxehtë shtëpiak

Ujë i nxehtë i përdorur në çdo lloj ndërtese, për qëllime shtëpiake.

Shitësi

Shpërndarësi i shitjeve për produktin.

Instaluesi i autorizuar

Personi me aftësi teknike, i cili është i kualifikuar për të instaluar produktin.

Përdoruesi

Personi që është zotëruesi i produktit dhe/ose operon produktin.

Legjislacioni në fuqi

Të gjitha direktivat, ligjet, rregullat dhe/ose kodet ndërkombëtare, evropiane, kombëtare dhe vendore, që lidhen dhe përdoren për një produkt ose domen të caktuar.

Kompania e shërbimit

Kompania e kualifikuar që mund të kryejë ose bashkërendojë shërbimin e kërkuar të produktit.

Manuali i instalimit

Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen.

Manuali i përdorimit

Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar përdorimin e tij.

Aksesorë

Etiketa, manuale, fletëudhëzues dhe pajisje, që dorëzohen me produktin dhe që kanë nevojë të instalohen në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Pajisjet opsionale

Pajisje prodhuar ose miratuar nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Furnizuar nga instaluesi

Pajisje të prodhuara JO nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet te dokumentacioni shoqërues.

12 Cilësimet për instaluesin: Tabelat për plotësim nga instaluesi

12.1 Ndhmuesi i konfigurimit

Cilësimi		Plotësoni...
Sistemi		
	Lloji i njësisë së brendshme (vetëm për lexim)	
	Emergjencia [9.5]	
	Kapaciteti i rezistencës përforcuese [9.4.1]	
	Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë [9.4.3]	
	Funksionimi [9.4.4]	
Depozita		
	Modaliteti i nxehjes [5.6]	
	Dezinfektim [5.7]	
	Maksimumi [5.8]	
	Histerezia [5.9]	
	Histerezia [5.A]	
	Vlera e caktuar e komfortit [5.2]	
	Vlera e caktuar ekonomike [5.3]	
	Vlera e caktuar e ringrohjes [5.4]	
	Modaliteti i vlerës së caktuar [5.B]	
	Lloji i kurbës në varësi të motit [5.E]	
	Modalitetet e funksionimit [5.G]	

12.2 Menyja e cilësimeve

Cilësimi		Plotësoni...
Informacion		
	Informacioni i shitësit [8.3]	

DAIKIN EUROPE N.V.

Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

4P680076-1C 2024.04